



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr 01-01404-56133 dt. 27.10. 2022

Bazuar në nenin 11, 12, dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34. pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Udhëzimin Administrativ(MAPL) NR. 02/2019, Për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane. Nenin 5 dhe 6 të udhëzimit administrativ për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më **27.10. 2022**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane më qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve, funksionimit dhe mbikëqyrjes së udhëheqësisë së fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit

Neni 1

Antarët e komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane më qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve, funksionimit dhe mbikëqyrjes së udhëheqësisë së fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit në këtë përbërje si vijon:

1. Arben Shala nga ekzekutivi
2. Shqipe Hoxha nga shoqëria civile
3. Fatmir Baliu antarë nga Kuvendi i Komunës
4. Hamit Haxhiu antarë nga Kuvendi i Komunës
5. Egzona Terdevci antarë nga Kuvendi i Komunës
6. Beqir Kiqina antarë nga Kuvendi i Komunës
7. _____ përfaqësues nga fshati.

Neni 2

Detyrat e komisionit janë organizimi i zgjedhjeve të organeve të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit në mbështetje të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës në fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane.

Neni 3

Më këtë vendim do të njoftohen anëtarët e komisionit, Drejtoritë e Komunës dhe zyra e Kuvendit si dhe një mbetet në arkiv.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;



Kryetari i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari